

10.2 DRITARJA PËR KËRKIM

Për kërkim në bazën e njësuar të të dhënave SGC hapet dritarja e ngjashme për kërkim sikurse në bazën e të dhënave CONOR.

Kërkimi - Regjistrimi i njësuar (SGC)

Kërkimi i specializuar =>

Pikëqasja: pust* AND

Pikëqasja e njësuar: AND

Pikëqasja nga sistemi tjetër: AND

Emri i përgjithshëm: AND

Emri gjeografik: AND

Kufizimi: TNR Skanimi:

Thyerja e rreshtit Formati i listës së rezultateve të kërkimit: Formati i paracaktuar Pyetësorët:

Numri i gjetjeve: 13

Nr.	SGC...	Lloji i pikëqasjes	Pikëqasja e njësuar	Pikëqasja e njësuar (eng)
5	1356...	j - emër i përgjithshëm	Pustolovski filmi	Adventure films
6	1356...	j - emër i përgjithshëm	Pustolovski radijski programi	Adventure radio programs
7	1356...	j - emër i përgjithshëm	Pustolovski televizivski programi	Adventure television programs
8	1391...	j - emër i përgjithshëm	Pust	Carnival
9	2285...	j - emër i përgjithshëm	Pustna oblaçila	Carnival costume
10	16488	j - emër i përgjithshëm	Pustolovščine	Adventures
11	1634...	j - emër i përgjithshëm	Pustni torek	Shrove Tuesday
12	1634...	j - emër i përgjithshëm	Pustne maske	Carnival masks
13	1027...	j - emër i përgjithshëm	Aridni kras	Arid karst

Fund

Figura 10.2-1: Shembulli i dritares për kërkim në bazën e të dhënave SGC

Dritarja për kërkim mund të hapet në shfletues ose në ndërfaqen për katalogim, në dritaren **Regjistrimi bibliografik** ose në dritaren **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**.

Procedura

Ndërfaqja për katalogim.

1. Përzgjidhni metodën **Kërkimi / SGC**.

Hapet dritarja **Kërkimi – Regjistrimi i njësuar (SGC)**.

Vazhdoni sipas procedurës së përshkruar në kap. 4.

Në pjesën e sipërme të dritares ndodhen fushat për kërkim, përmes të cilave mund të kërkoni regjistrimet e njësuar. Nën fushat për kërkim ndodhen fushat "Skanimi" dhe "Kufizimi".

Në pjesën e poshtme të dritares për kërkim shfaqen regjistrimet e njësuar që përputhen me pyetjen për kërkim. Me ngjyrë gri janë regjistrimet e papërfunduara, që do të thotë se ende nuk janë verifikuar dhe nuk janë futur në listën e emërtimeve lëndore. Me ngjyrë gri janë edhe regjistrimet e

përzgjedhura për t'u fshirë (001a = "d") si dhe regjistrimet e përzgjedhura për t'u ndarë (001a = "r").

Teknika e kërkimit është e njëjtë me teknikën e kërkimit në bazën e njësuar të të dhënave CONOR dhe përshkruhet në kap. 9.2, ndërsa indekset për kërkim në bazat CONOR dhe SGC, për shkak të përmbajtjeve të ndryshme, dallojnë. Lista e indekseve për kërkim që përdoret te kërkimi i specializuar në bazën SGC është në shtojcën A.3.